



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3136_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës me shenjen K.DH.SH.II.nr. 1424/25;
- Rekomandimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK_R_2890_02_26, i dt. 04.02.2026.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M -

- I. **REFUZOHET** ankesa e subjektit juridik **R. B., SHPK.**, përfaqësuar nga N. Sh., lidhur me kundërshtimin e liberalizimit të tregut të energjisë, si e pa bazuar.
- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Subjekti juridik R. B., SHPK., me datë 10.09.2025, ka parashtruar ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, përmes së cilës e kundërshton procesin e liberalizimit të tregut, me arsyetimin se e plotëson vetëm njërin kriter ligjor për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Bordi i ZRrE-së e ka analizuar me kujdes rastin e konsumatorit, dhe duke iu referuar të dhënave zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës, vihet re që, subjekti juridik R. B., SHPK., me NUI i ka mbi 51 të punësuar dhe rrjedhimisht, i plotëson kriteret për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, është një detyrim ligjor, i përcaktuar me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016. Në këtë kuptim, procesi i derregullimit dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, në ligjet e sektorit të energjisë, derivon nga obligimet kontraktuale që ka Republika e Kosovës, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

ZRrE rithekson faktin se, procesi i liberalizimit, është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 dhe në vendimin përkatës të ZRrE-së, për daljen në tregun e hapur për ndërmarrjet ekonomike, të cilat e tejkalojnë njërin nga kriteret e përcaktuara – më shumë se 51 të punësuar ose qarkullim vjetor mbi 10 milionë EUR.

Po ashtu, edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me shenjen P.A. nr. 18/2025, është vërtetuar se e drejta për furnizim me tarifa të rregulluara, u takon vetëm konsumatorëve të kualifikuar për Shërbim Universal, që është në përputhje të plotë me Vendimin e Bordit të ZRrE-së për tarifat me



pakicë për vitin 2025 dhe Direktivën për Energji Elektrike të Bashkimit Evropian 2009/72/EC. ZRrE sipas dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike, ka për obligim të përcaktojë tarifa të energjisë elektrike me pakicë, vetëm për konsumatorët e energjisë elektrike që e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe jo për konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e furnizimit me shërbim universal. Rrjedhimisht, Ligji për Energjinë Elektrike përcakton që, këta konsumatorë duhet të furnizohen në treg të hapur. Furnizimi me energji elektrike në tregun e hapur për këta konsumatorë, është detyrim ligjor dhe në këtë kuptim, i tejkalon kompetencat e ZRrE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- Arkivit të ZRrE-së
- Subjektit juridik R. B., SHPK., (N. Sh.,)